



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 .

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 332/Prot.
5

Tiranë, më 28.07 . 2015

V E N D I M

Nr. 73 , datë 28 07 /2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil,
Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes të zhvilluar në Njësinë Bashkiake Nr. 2, Tiranë,

VËREJ SE:

Në zbatim të vendimit nr. 36, datë 23.04.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë", filloi mbikëqyrja e përgjithshme në subjektin, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë.

Objekti i mbikëqyrjes ishte i përgjithshëm dhe përfshinte monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe akteve nënligjore, gjatë aplikimit të gjithë instituteve të tij, si dhe arsyet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë.

Procesi u zhvillua në përputhje me programin e mbikëqyrjes nr. 332/2 prot., datë 23.04.2015, njoftuar institucionit me shkresën nr. 332 prot., datë 23.04.2015, "Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes".

Në përfundim të këtij procesi, grupi i mbikëqyrjes hartoi projektraportin dhe ia dërgoi për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 332/3, datë 02.07.2015, duke i lënë 7 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Në vijim të procesit, nga ana e Njesisë Bashkiake Nr. 2, Tiranë, me shkresën nr. 3768/1 prot., datë 10.07.2015, është kthyer projektraporti i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, pa paraqitur observacione.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, në përfundim të këtij procesi, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë, i cili është pjesë e këtij vendimi.
 2. Njësia Përgjegjëse duhet të fillojë procedurën për revokimin e akteve si më poshtë:
 - Revokimin e aktit administrativ nr. 1549 prot., datë 12.05.2014 për transferimin e nëpunësit ***** në pozicionin "*Specialist Tregu*" dhe të aktit nr. 1659 prot., datë 20.05.2014, për transferimin e nëpunësit ***** në detyrën "*Përgjegjës Sektori*", në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe kthimin e tij në pozicionin "*Specialist Tregu*" (Veteriner).
 - Revokimin e aktit nr. 3748/2 prot., dt. 11.11.2014 për deklarimin statusit të punësimit "*Nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore*", për nëpunësin ***** dhe lëshimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit për këtë punonjës, "*Nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin Specialist Tregu (Veteriner)*".
- Rekomandohet njësia përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit që vendin e punës "*Përgjegjës Sektori*" në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore ta shpallë vend të lirë, për t'u plotësuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji.
- Revokimin e aktit administrativ nr. 1480 prot., dt. 11.03.2015, për transferimin e nëpunëses ***** , në detyrën "*Specialist Taksash*" dhe kthimin e saj në pozicionin "*Specialist Tregu*".

Revokimin e aktit administrativ nr. 3748/1 prot., dt. 11.11.2014, për deklarimin e statusit të punësimit “Nëpunës civil” për nëpunësen ***** dhe lëshimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit për këtë punonjëse “Nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, Specialist Tregu”.

- Revokimin e aktit administrativ nr. 3748/1 prot., dt. 11.11.2014, për deklarimin e statusit të punësimit “Nëpunës civil në pozicionin Përgjegjës Sektori në Sektorin e Infrastrukturës” për nëpunësin ***** dhe lëshimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit për këtë punonjëse “Nëpunës civil në periudhë prove”.

Në këtë rast njësia përgjegjëse duhet të marrë masat për të zbatuar të gjitha detyrimet ligjore që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASP); për caktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori dhe pas kësaj duhet të shprehet për konfirmimin ose jo të nëpunësve civilë në periudhë prove.

3. Njësia përgjegjëse duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësit ***** emëruar me urdhrin nr. 2451 prot., dt. 28.06.2013, në pozicionin “Specialist Infrastrukture” dhe ***** emëruar me urdhrin nr. 2034 prot., dt. 04.08.2011, në pozicionin “Specialist Tregu”, duke evidentuar faktin se nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, për arsyet e parashtruara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes dhe pozicionet e punës të shpallen të lira për t’u plotësuar në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
4. Institucioni i mbikëqyrur të revokojë aktet administrative të emërimit për punonjësit ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** dhe ***** , si aktë që kanë dalë në kundërshtim me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Pozicionet e punës që mbajnë këta nëpunës të shpallen vende të lira për t’u plotësuar në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
5. Institucioni i mbikëqyrur, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme dhe Departamentin e Administratës Publike, të qartësojnë pozicionin e nëpunësve të gjendjes civile në raport me shërbimin civil. Pasi të ezaurohet ky bashkëpunim, të vijojnë procedurat lidhur me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe lëshimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile, ***** , pozicioni i punës “Përgjegjës zyre”; ***** , pozicioni i punës “Specialist”; ***** , pozicioni i punës “Specialist”; ***** , pozicioni i punës “Specialist” dhe ***** , pozicioni i punës “Specialist”.
6. Njësia përgjegjëse të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës për pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, lidhjes 4,

bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*.

Në zbatim të rekomandimeve të materializuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe me Departamentin e Administratës Publike, të hartohen përshkrimet e punës për pozicionet që i përkasin Zyrës së Gjendjes Civile.

7. Rekomandohet njësia përgjegjëse që, në rastet e një ecurie disiplinore ndaj një nëpunësi civil, të respektojë kërkesat e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar (kreu X *“Disiplina në shërbimin civil”*), si dhe procedurat e parashikuara në Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimim e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, me qëllim që nëpunësve civilë t’u garantohet e drejta për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, e drejta për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike, e drejta për t’u asistuar, si dhe e drejta për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar.
8. Rekomandohet njësia përgjegjëse që, në rastet e evidentuara të akteve të deklarimit të statusit të punësimit të regjistruara me të njëjtin numër protokolli dhe në të njëjtën datë, për rregullimin e ligjshmërisë, të krijojë një praktikë të re regjistrimi, ku aktet e deklarimit të statusit të punësimit, të protokollohen (*të regjistroheshen*) me fraksion progresivisht me numrin rendor të plotë që është protokolluar, urdhri i titullarit të institucionit për nxjerrjen e akteve të deklarimit.
9. Institucioni i mbikëqyrur duhet të mbajë parasysh rekomandimet e Komisionerit në lidhje me zbatimin e menjëhershëm të vendimit nr. 76, dt. 12.05.2012, të ish Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi me vendimin nr. 85, dt. 26.09.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë, për punonjësën ***** dhe Vendimin nr. 149, dt. 20.09.2012, të ish Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi me vendimin nr. 13, dt. 31.01.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, për punonjësën Liri Braçe, sipas përcaktimeve të nenit 66/1, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, me qëllim që të evitohen pasojat negative në buxhetin e shtetit, për shkak se në këto raste paguhen dy punonjës për një vend pune.
10. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim, duke marrë parasysh se zbatimi i tij kërkon një kohë të kushtëzuar nga afatet procedurale të veprimeve që duhet të kryhen në këtë rast për rregullimin e situatës.

Në këtë rast, zbatimi i këtij vendimi duhet të trajtohet i lidhur ngushtë edhe me veprimet që do të kryhen për implementimin e reformës në administratën vendore.

Nga ky afat, bën përjashtim pika 9 e vendimit, pasi afatet e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës ë prerë ndiqen sipas procedurave specifike të kësaj fushe.

11. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë këtë vendim, duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
12. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
13. Për këtë vendim të njoftohet Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë; Departamenti i Administratës Publike; Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA